



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.01, datë 03.10.2018

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I GODINËS QËNDRORE DHE SHITESË ANËSORE PËR
AGJENCINË E KONTROLLIT TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE,
BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i godinës qendrore dhe shtesë anësore për Agjencinë e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJËNCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

